



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:032809

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06375621

APS.nr.37/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Bashkim Hyseni kryetar i kolegjit, Burim Ademi dhe Vatton Durguti anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Gazmend Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarve J.D dhe S.S, për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile, e cila parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje KPRSFJ), e që në kohën kur është ngritur aktakuza ishte penalizuar me nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082), tutje (KPRK) e cila është në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët dhe nenin 4 të protokollit shtesë II dhe të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PPS.nr.12/2024 i datës 18.06.2024, në seancën e kolegjit me datë 20.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PPS.nr.12/2024 i datës, 18.06.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, ka marrë aktgjykimin PPS.nr.12/2024 i datës 18.06.2024, i ka liruar nga akuza, të akuzuarit J.D dhe S.S për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile, e cila parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të Ligjit

Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje KPRSFJ), e që në kohën kur është ngritur aktakuza ishte penalizuar me nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082), tutje (KPRK) e cila është në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët dhe nenin 4 të protokollit shtesë II dhe të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, për shkak se nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes se procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, dhe të shkeljes së ligjit penal me propozim që të aprovohet ankesa, aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim dhe rivendosje.
- Përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit S.S av. Artan Qerkini për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, dhe të shkeljes së ligjit penal, me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.
- Përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit J.D av.Mexhit Sylja, me propozim që me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.446/23 të datës 29.07.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale, kurse aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Ndërsa pergjigjet në ankesën e prokurorisë të parashtruara nga mbrojtësit e të pandehurve av.J.D dhe av. Mexhit Sylja të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit fillimisht ka vlerësuar ankesën nëse është e lejueshme dhe e afatëshme. Kolegji ka gjetur se ankesa është e lejueshme, duke qenë se është parashtruar nga ana e prokurorisë. Po ashtu ankesa rezulton se është e afatëshme, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se ndaj aktgjykimi te ankimuar prokuroria ka parashtruan ankesë me datë 10.07.2024, kurse përgjigje në

ankesën e prokurorisë kanë parashtrua av.Artan Qerkini me datë 22.07.2024, dhe av.Mexhid Sylja me datë 17.07.2024 . Nga këto rrethana rezulton se ankesa është brenda afatit që parasheh neni 380 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën ka njoftuar palët për vendin, kohën e mbajtjes së seancës. Në këtë seancë nuk kanë prezantuar: Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse ftesat është dërguar në mënyrë të rregullt. Ndërsa, janë të pranishëm i akuzuari J.D, av. Mexhit Sylja, i akuzuari S.S, av.Artan Qerkini.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të prokurorisë, përgjigjen në ankesë mbrojtësve të akuzuarve, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore.

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, theksohet se sa i përket lirimit nga akuza ndaj të akuzuarve, gjykata gabimisht ka ardh në përfundim se nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale, në rastin konkret gjykata pas analizës së provës personale përkatësisht deklaratave të dëshmitarit A, nuk ka arritur të krijoj bindjen se të akuzuarit J.D dhe S.S të kenë ndërmarrë veprime kundrejt një personi të paidentifikuar duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritshme, me anë të së cilave veprime do të cenonin shëndetin dhe integritetin e tij dhe të vërtetohej kështu fakti se këto veprime kanë përfshirë pasoja të rënda për viktimën, pra përmes deklaratimit të dëshmitarit A, nuk është arrit të vërtetohet se a janë ndërmarrë apo jo veprime inkriminuese ndaj personit të pa identifikuar dhe se çfarë pasoja të rënda i janë shkaktuar, sepse nuk ka pasur provë tjetër mbështetëse e cila do ta kishte mbështetur dëshminë e dëshmitarit A, e në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar gjykata ka konstatuar se te akuzuarit nuk mund të shpallehin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë të dëshmitarit. Tutje thekson se gjendja faktike e përshkruar si në dispozitave të aktakuzës dhe sipas dëshmie të dëshmitarëve A dhe B është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen. Sa i përket shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale konsideron se ne rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore ngase mungon arsyetimin bindes i gjykatës, gjithashtu ka bërë edhe shkelje te ligjit penal duke. Me tutje thekson se gjykata e shkallës së parë

po ti vlerësonte drejtë provat nuk do ti falte besimin mbrojtjes së të akuzuarve por do ti shpallte fajtor pasi që në veprimet e tyre formësohen elementet e veprës penale e cila iu vihet ne barrë duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovon si të bazuar ankesën dhe të veproi sipas propozimit në ankesë.

Përgjigje ne ankesë e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit S.S av.Artan Qerkini, duke konsideruar se në këtë çështje penale asnjëra nga pretendimet ankimore të PSRK-së nuk është e qëndrueshme. Rrjedhimisht, pretendimet ankimore të PSRK-së se aktgjykimi lirues është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe se aktgjykimi nuk përmban faktet vendimtare dhe se i njëjti është i mangët janë të pabazuara. Kjo pasi Gjykata ka përpiluar aktgjykimin lirues konform dispozitave 369 të KPPRK-së, gjegjësisht aktgjykimi përmban hyrjen, diapozitivit dhe arsyetimin, i njëjti aktgjykim përmban të gjitha elementet e përmbajtjes dhe formës të paraparë me KPPRK, dhe gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.

Përgjigje në ankesë e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit J.D av. Mexhid Syla duke konsideruar se pretendime e prokurorisë janë në kundërshtim të plotë me atë që thuhet aktgjykimin e ankimuar, ngase aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurës penale, se gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, e për rrjedhojë nuk ka ndodhë dhe shkelja e ligjit penal ashtu si gabimisht pretendohet në ankesë. Nga përmbajtja e aktgjykimit të ankimuar, shihet se i njëjti është përpiluar në plotin me atë që parashihet me nenin 370 të KPPRK-së si për nga përmbajtja ashtu edhe forma e tij. Andaj, konsideron se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar qartë ka paraqitur përmbajtjen e dispozitivit të aktgjykimit, pastaj rrjedhën e procedurës në këtë çështje penale prej ngritjes së aktakuzës deri në ditën e marrjes së këtij aktgjykimi, provat e administruara dhe vlerësimin e tyre veç e veç e në lidhshmëri me njëra tjetrën.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore te prokurorisë, lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, qofshin shkelje që kujdeset sipas detyrës zyrtare vet Gjykata e Apelit apo qofshin shkelje që pretendohet në ankesën e prokurorisë.

Kolegji i kësaj gjykate, vëren se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje të kategorisë së natyrës absolute që përcaktohen në nenin 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 deri në 1.10, gjegjësisht ky kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje penale ka dhënë arsyet për faktet vendimtare që kushtëzojnë marrjen e vendimit në përputhje me dispozitat ligjore.

Poashtu kolegji vëren se në aktgjykimin e ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë në pjesën e dispozitivit ka përshkruar, kohën rrethanat dhe mënyrën nën të cilat pretendohet nga akuza e prokurorisë se të pandehurit kanë kryer veprën penale që ngarkoheshin sipas akuze, gjë që rezulton se dispozitivi ka të përshkruara të gjitha rrethanat e fakteve dhe se nuk ka asnjë kundërtënie në veten e tij e as në raport me dispozitat ligjore që ngarkoheshin te pandehurit për veprën penale.

Poashtu aktgjykimi në pjesën arsyetuese të tij, ka të dhëna arsyet si për sa i përket rrjedhës së procedurës duke qenë se kjo çështje penale ishte kthyer në rigjykim, pastaj vlerësimin të provave që janë administruar gjegjësisht dëshminë e dëshmitarit A, deklaratat e të pandehurve që janë dhënë në fazat e më hershme të procedurës penale pasi që në rigjykim të pandehurit kanë shfrytëzuar të drejtën tyre për tu mbrojtur në heshtje, dhe poashtu një aplikacion për aplikim të statusit të veteranit të dëshmitarit A, çka rezulton se ishin vetëm këto prova që edhe vet prokuroria kishte propozuar që të administrohen për qëllim të vërtetimit të fakteve që pretendoheshin në akuzë.

Nga arsyetimi i aktgjykimit rrjedhë se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye në raport me secilën provë që janë administruar në shqyrtimin gjyqësorë, e që ka bërë vlerësimin e tyre në mënyrë të vetme të secilës provë dhe poashtu ka bërë vlerësimin e tyre në lidhshmërinë e të gjitha provave.

Tutje në aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë është kujdesur që të arsyetohen se cilat janë shkaqet që ka ardhur në përfundimin se me provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale.

Kolegji ka parasysh se ankesa e prokurorisë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale shtrohet në çështjen e vlerësimin të provave gjegjësisht deklaratës së dëshmitarit A që gjykata në aktgjykim ka arsyetuar se përse ka konsideruar se kjo provë nuk

është e besueshme për të ardhur ne përfundimet se provohen faktet që pretendoheshin se të pandehurit, S.S dhe J.D kanë kryer veprën që ngarkoheshin sipas akuzës së prokurorisë.

Kolegji i gjykatës se Apelit nuk e gjen të bazuar pretendimin e prokurorisë kur thekson në ankesë se shkeljet esenciale rezultojnë pasi që gjykata gabimisht ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit A dhe gabimisht nuk ia ka falur besimin. Ky kolegji nuk mund të pranoj një pretendim të tillë si të drejtë dhe të bazuar, duke qenë se në aktgjykimin e ankimuar rrjedhë se në faqe, 23, 24 dhe 25 të aktgjykimit e veçanërisht në faqe 25 pasuesi 2 ku gjykata shpërfaq kundërthëniet e deklarimeve të dëshmitarit A, që kanë të bëjnë me faktet e kësaj çështje penale ka dhënë arsye shumë konkrete dhe të plota se përse gjykata e shkallës së parë nuk ia ka falur besimin kësaj deklaratë.

Kolegji duke akceptuar në tersi arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë lidhur me deklaratën e dëshmitarit A, njëkohësisht rikujton se, një prove në procedurën penale duhet ti ketë të paktën, relevancën, besueshmërinë dhe forcën provuese, gjë që në rastin konkret relevanca e deklaratës së dëshmitarit A rezulton duke qenë se i atribuohet fakteve që kanë qenë objekt shqyrtimi, ndërsa besueshmëria ka të bëjë me saktësinë dhe konkretën e saj, gjë që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka argumentuar për pasaktësitë lidhur me faktet e që rezultojnë pasaktësitë nga vet deklarimi i dëshmitarit A, ku gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar në faqe 25 pasuesi 2 të aktgjykimit se cilat rrethana rezultojnë të pasakte gjegjësisht se për të njëjtat fakte dëshmitari i njëjtë në faza të ndryshe të procedurës ka deklaruar ndryshe, ndërsa kur kemi të bëjmë me fuqinë provuese të provës ajo duhet të ketë përputhje vërtetimi dhe konsistencë të brendshme, në rastin konkret rezulton se dëshmitari A, ka theksuar për tri rrethana vendimtare të fakteve deklarime të ndryshme, fillimisht lidhur me rrethana se sa persona kanë qenë të ndaluar në momentin kur ai pohon se i kanë sjellë tre vëllezër nga rajoni i Mitrovicës, duke qenë se njëherë thotë se kemi qenë 4 persona me emër ndërsa në një fazë tjetër thotë se kemi qenë vetëm dy persona kur i kanë sjellë vëllezërit nga rajoni i Mitrovicës, pastaj lidhur me shkakun apo motivin që deklaroi dëshmitari se njeri nga këta vëllezërit që ishin sjellë ishte rrahur në një situatë si motiv e paraqet se ata iu kishin shitur disa dele Serbeve ndërsa në një fazë të mëtejshme deklaroi se ata e rrahën njërin nga vëllezërit nga rajoni i Mitrovicës për shkak se ai e shante UÇK, pra për këto fakte si për sa i përket motivit dhe si për sa i përket pranisë së personave dëshmitari shpërfaq mospërputhje në deklarimin e vet, lidhur me vërtetimin e fakteve që mund të jep deklarata e dëshmitarit A, poashtu gjykata verën se ka mungesë të vërtetësisë së fakteve, pasi që në njërin nga deklarata pohon dëshmitari, se njërin nga tre vëllezërit e rajonit të Mitrovicës – nga Shipoli

që i kishin sjell aty, atë e rrahën të pandehurit S.S dhe J.D me grushte dhe shqelma pa ndërprerë ndërsa thekson se ai qëndronte në këmbë, pastaj thekson se serish e morën dhe e qiten jashtë dhomës dhe u dëgjuan britmat, tani në rrethana të rastit kur pohon se e rrahën me grushte dhe shqelma ndërsa thekson se ai qëndronte në këmbë kjo është pak e besueshme duke qenë se asnjë person nuk do të mund të qëndronte në këmbë përderisa dy persona e godasin me grushte dhe shqelma gjë që ka të bëjë me provueshmërinë e faktit të ngjarjes, ndërsa në situatën e dytë kur dëshmitari thekson se atë e morën dhe e qiten jashtë dhe u dëgjuan britma, ky fakt mbetet tërësisht i pa mbështetur me tutje në prove konkrete duke qenë se, nuk rezulton i provuar fakti se ishin të pandehurit edhe jashtë dhomës ata që supozohet se e kanë rrahur njërin nga vëllezërit nga Shipoli i Mitrovicës, pasi që ai nuk ka pohuar se i ka parë duke e rrahur por vetëm pohon se ka dëgjuar brima, gjë që për këto rrethana te fakteve kolegji vlerëson se vërtetimi i fakteve pa mëdyshje për t'ia falur besimin dhe për të konkluduar se janë provuar rrethanat faktike, në këtë kuptim duke qenë se për faktet vendimtare deklarata e dëshmitarit A rezulton me mospërputhje dhe me vërtetësi përtej çdo mëdyshje për faktet vendimtare, kolegji ka parasysh se i mungon konsistenca e brendshme deklaratës së dëshmitarit A, për tërësinë e rrethanave faktike dhe rrjedhimisht për këto arsye edhe Gjykata e Apelit vlerëson se arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë përveç se janë të pranueshme ato janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe se këto arsye aktgjykimin nuk e bëjnë me shkelje esenciale por se aktgjykimi është përpiluar në harmoni me vet dispozitat ligjore e kërkojnë.

Lidhur me pretendimet ankimore të vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, kolegji i gjykatës së Apelit fillimisht vëren se në ankesën e prokurorisë, nuk ka pretendim konkret se cili fakt apo fakte pretendohet se nuk janë vërtetuar drejte apo nuk janë vërtetuar në mënyrë të plote.

Kolegji ka parasysh se të pandehurit ngarkoheshin për këto rrethana, “ Në një datë të papërcaktuar të muajit gusht ose shtator të vitit 1998 të akuzuarit e lartcekur, kanë kryer Krime lufte kundër popullatës civile, që parashihet dhe dënohet me Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ (e që në kohën e ngritjes së aktakuzës ishin penalizuar me Nenet 31 dhe 152 të KPRK), sepse, në kundërshtim me Nenin 3 të Përbashkët dhe Nenin 4 të Protokollit Shtesë II dhe të gjithë rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë aktakuzë, i akuzuari J.D, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në bashkëkryerje me S.S po ashtu në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të

paidentifikuar nga lagja Shipol në Mitrovicë, i ndaluar në qendrën e ndalimit të Likovcit, duke e rrahu atë në mënyrë të përsëritshme”.

*Rrjedhimisht prokuroria pretendon se të pandehurit kanë kryer veprën penale, **Krime lufte kundër popullatës civile që parashihet dhe dënohet me nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ (që në kohën e ngritjes së aktakuzës penalizohej me nenet 31 dhe 152 të KPRK-së) në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët dhe nenin 4 të Protokollit Shtesa II dhe të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur.***

Kolegji ka parasysh se çështja thelbësore si veprim inkriminues që iu mvishej te pandehurve, ishte pretendimi i prokurorisë, për cenimin e integritetit trupor ku si veprime theksohet se kanë rrahur një person nga Shipoli i Mitrovicës që ishte i ndaluar në qendrën e Likovcit.

Kolegji ka parasysh se rrethanat e tilla mbështeteshin veten nga deklaratat e dëshmitarit A që ishin dhënë në fazën e hetimeve dhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor paraprak.

Në këtë kontekst marre për bazë se, siç u theksua me sipër për faktet që prokuroria i ngarkonte te pandehurit, pra cenimin e integritetit trupor duke e rrahur personin e panjohur nga Shipoli i Mitrovicës, këto rrethana mbështeteshin vetëm nga deklaratat e dëshmitarit, e ku u sqarua me sipër se për faktet me thelbësore ka mospërputhje te dëshmitarit, (gjë që kolegji ka parasysh se ka mundësi që dëshmitarit edhe mund të mos i jen kujtuar në detaje rrethanat e ngjarjes duke vlerësuar çështjen se kur ishin dhënë ato deklaratat), megjithatë për faktet që do ta bënin të besueshme dhe për tu konsideruar provueshmëria e fakteve pa mëdyshje, rezulton se dëshmitari në periudha të shkurtër deklaroi për ato fakte ndryshe, siç është rasti kur ai me deklaratën e datës 17.07.2014 në shqyrtim gjyqësor thekson se kemi qene 4 persona gjate kapjes se tre vëllezërve nga Shiplo i Mitrovicës, ndërsa për këtë rrethana me date 18.07.2014 thekson se ka qene vetëm Genc Vasileva në dhomë kur janë sjellë vëllezërit nga Shiplo i Mitrovicës. Poashtu dëshmitari tutje thekson se njeri nga vëllezërit është rrahur sepse ata iu kishin shitur dele serbeve pastaj thekson se është rrahur sepse shante UÇK, pastaj poashtu thekson se njeri nga vëllezërit është rrahur në prani të tije në dhomë ku viktimat qëndronte në kebe, pastaj thekson se tutje e kanë marr jashtë dhe ka dëgjuar brima.

Te gjitha këto rrethana mbështeten vetëm nga ky dëshmitar dhe nuk ka asnjë provë tjetër që mbështete faktet e çështjes penale për këto rrethana qoftë prove personale apo prove materiale, gjithnjë sa i përket veprimeve të dhunshme të të pandehurve që ngarkohen për cenimin e dinjitetit trupor ndaj një personi nga Shipoli i Mitrovicës.

Kolegji ka parasysh se vlerësimi i gjykatës së shkalles se pare nuk ka te bëje me mos vërtetim të drejte dhe të plotë të gjendjes faktike, por ka të bëjë me vlerësim në tersin e kontekstit të rrethanave, për ta vlerësuar nëse mbi bazën e kësaj prove rezultojnë të provuara faktet e çështjes për të ardhur në një përfundim se të pandehurit kanë kryer veprën penale. Andaj kolegji i apelit i pranon si të drejta dhe të qëndrueshme faljen e besimit të deklaratës së dëshmitarit A dhe vlerëson se mbi këtë provë nuk arrihet të provohen faktet që prokuroria ia venë në barrë të pandehurve dhe se i drejtë dhe i ligjshëm rezulton edhe vendimi kur gjykata i ka liruar nga akuza të panderit.

Kolegji me specifikisht ka parasysh se veprimet e tilla të të pandehurve pretendohet nga ana e prokurorisë se janë veprime dhune apo torture, që bien në kategorinë e nenit 3 të përbashkët për konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949, paragrafi 2.1, që parasheh se: Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura.

Për të vlerësuar çështjen e aktit të dhunës apo torturës, gjykata duhet ti ketë parasysh dy momente kur dëshmitari A, thekson se të pandehurit kanë vepruar ndaj personit të panjohur nga Shipoli i Mitrovices. A) momenti kur dëshmitari thekson se është rrahur në dhomë njeri nga vëllezërit e paidentifikuar gjersa dëshmitari ishte prezent, b) momenti kur dëshmitari A thekson se njeri nga vëllezërit e paidentifikuar është nxjerr jashtë dhomës dhe se dëshmitari A ka dëgjuar britma.

Kolegji ka parasysh se momenti i parë i pohimit të dëshmitarit, ku ai sqaron se njeri nga vëllezërit është rrahur në dhome ku viktima ka qëndruar në këmbë ndërsa të pandehurit e kanë goditur me grushte dhe shqelma, përveç se rezulton fakti i paprovuar duke qenë se logjikshëm kur një person goditet nuk mund të qëndroj në këmbë për me tepër kur goditet nga dy persona me grushte dhe shqelma, prandaj fakti i tillë i rrahjes që pohohet nga dëshmitari A, për njërin nga vëllezërit në brendësi të dhomës, rezulton i paprovuar përtej dyshimit, për tu kategorizuar se kemi të bëjmë me dhunë apo torture si veprime që do të cenonin dinjitetin e jetës se duke vlerësuar si thelbësore se personi që pretendohet se ishte rrahur nuk ishte identifikuar asnjëherë e rrjedhimisht nuk mund ti mvishet të pandehurve se kishte cenim të dinjitetit ndaj jetës.

Ndërsa momenti tjetër që dëshmitari A kur thekson se njeri nga vëllezërit ishte marr nga dhoma dhe ishte vendosur jashtë ku dëshmitari nga dhoma kishte dëgjuar bërtima, kolegji ka parasysh se kjo rrethanë e pohimit të dëshmitarit A a duhet kategorizuar si thashetheme apo supozim se

personi i panjohur nga Shiploi i Mitrovicës, ishte rrahur duke përdorur dhunë të pandehurit ndaj tij. Kolegji vlerëson se ky pohim nuk hynë në kategorizimet e thashethemeve por hynë në kategorizimet e supozimeve, duke qenë se dëshmitari përderisa thekson se ka dëgjuar britma ka supozuar se është rrahur personi i panjohur nga Shipoli i Mitrovicës. Në këtë kontekst duke mos pasur asnjë prove qoftë edhe rrethore për të mbështetur këtë rrethanë të pohuar nga dëshmitari se ai ka dëgjuar britma dhe për të ardhur në përfundimin se të pandehurit kishin përdorur dhunë, në mënyrë që të vihet në një përfundim të vetëm se veprimet e të pandehurve kishin cenuar dinjitetin e personit të panjohur nga Mitrovica, kolegji duhet ta vlerësoj për këto rrethana vetëm supozimin e dëshmitarit, se britmat që ai i kishte dëgjuar a kishin të bënë me dhunën që pretendon prokuroria se të pandehurit kanë ushtruar dhe kanë cenuar dinjitetin e personit të panjohur nga Shipoli i Mitrovicës apo mbesin në nivelin e supozimit se britmat nuk qojnë në konkludimin se ka pasur edhe dhunë nga të pandehurit ndaj personit të panjohur.

Për ta vlerësuar supozimin kolegji ka parasysh se jo çdo supozim duhet përjashtuar apriori për të mbështetur një fakt, megjithatë për të mbështetur një fakt mbi një supozim duhet që lidhshmëria e fakteve të tërësishme të jetë aq e ngushtë sa të qojë vetëm në një përfundim se supozimi është i pranueshëm nga se nuk rezulton asnjë rrjedhe normale e ngjarjes “ e kjo mbështete edhe në teorinë res gestae”, në këtë kontekst meqë vetëm supozimi i dëshmitarit A që duke i dëgjuar britmat edhe prokuroria ka pretenduar se është rrahur personi i panjohur nga Shiploi i Mitrovicës dhe në mungesë të një prove qoftë edhe rrethore që do ta mbështeste këtë supozim, e duke marr për bazë faktin se edhe pohimi i dëshmitarit kur thekson se personi i panjohur është rrahur në dhomë me grushte dhe shkelma nuk rezulton i provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, kolegji pohimin e dëshmitarit se ka dëgjuar britma kur është marr personi i panjohur nga Shipoli i Mitrovicës dhe ishte vendosur jashtë dhomës e vlerëson se mbetet vetëm në nivel të supozimit se ndaj atij personi të panjohur të jetë ushtruar dhunë dhe se nuk ka asnjë provë tjetër që mbështetë faktin e tillë të dhunës e rrjedhimisht nuk provohet se as në këto rrethana të pandehurit të kenë përdorur dhunë apo torturë për të cenuar dinjitetin e personit të panjohur nga Shipoli i Mitrovicës.

Prandaj duke i gjetur si të bazuara arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe për këto arsye të theksuara si më sipër, ky kolegji vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe si të drejtë e të ligjshëm e vlerëson vendimin e ankimuar kur ka konstatuar se nuk është provuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkoheshin nga prokuroria në aktakuzë.

Lidhur me pretendimet e prokurorisë për shkelje të ligjit penal kolegji ka parasysh se gjykata e shkallës së parë përveç se ka zbatuar drejtë ligjin penal ka dhënë arsye të shumta e në detaje lidhur me zgjidhjen e çështjeve ligjore që i ka bërë me rastin e marrjes së vendimit të tillë, duke iu referuar edhe praktikës ndërkombëtare lidhur me zbatimin e dispozitave që lidhen me nenin 3 dhe 4 i përbashkët për katër konventat e Gjenevës, duke elaboruara se cilat janë niveli i pasojave lidhur me dhunën apo torturën që duhet të rezultojnë, gjë që në rastin konkret nuk rezulton asnjë nivel i pasojave të jetë provuar duke qenë se nuk dihet fare personi ndaj të cilit pretendohet se ishte ushtruar dhunë. Andaj kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë ligjin penal kur ka ardhur në përfundimin se nuk është provuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale.

Andaj për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 401 të KPP-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti Special

APS.nr.37/2024 me datë 20.09.2024

B. Profesional
Gazmend Ramadani

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetar i kolegjit,
Bashkimi Hyseni

Vaton Durguti
